

URDHËR
Nr. 128, datë 11.4.2019

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, zëvendësministrit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, z. Elton Haxhi.
2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, deleguar sipas pikës 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data 11.4.2019 deri më 15.4.2019.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, z. Elton Haxhi.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Anila Denaj